



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:033019

Datë: 20.08.2024

Numri i dokumentit: 06090384

2021:047326

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me zyrtaren ligjore Kimete Bytyqi, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.H. për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 par.4 lidhur me par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vepruar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm PP/II.nr.220/21, të datës 11.03.2021, ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor më datën 16.08.2024, në prani të Prokurorit të Shtetit Sadat Topalli, të dëmtuarit M.R., të dëshmitarëve H.R. e A.R., të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij të caktuar sipas detyrës zyrtare Av.Vehbi Kashtanjeva dhe po të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, kurse më datë 20.08.2024, përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari A.H., (pseudonimi G.), nga i ati H, e ëma A., e gjinisë A., i lindur me dt.... në Prishtinë, me vendbanim në fshatin ... K Ferizaj, me numër personal, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i martuar baba i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë për ndonjë veprë penale, ndaj tij nuk zhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datë 23.10.2020, rreth orës 23:00, në fshatin ..., komuna Ferizaj, saktësisht në parkingun e kafenesë “R.”, i pandehuri me qëllim të shkaktimit të ankthit apo frikësimit dhe me përdorimin e armës së gjuetisë të tipit “Over & Under”, prodhim turk, me numër serik S ..., me kalibër .. AG, seriozisht i kanoset të dëmtuarit M.R., në atë mënyrë që pas mosmarrëveshjes që e kishin pasur pasi që i dëmtuari i kishte kërkuar të largohet nga lokali, i pandehuri ishte larguar me veturë e tij të markës “Suzuki”, dhe kishte shkuar në shtëpinë e tij ku kishte marrë armën e gjuetisë, dhe ishte kthyer prapë te kafeneja dhe pasi që kishte dalë i dëmtuari e kishte hapur dritaren dhe e kishte vendosur tytën e armës në dritare të veturës, në momentin që niset me veturë ju drejtohet me fjalët “se kjo punë nuk ka me mbet me kaq”.

Me këtë ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 par.4 lidhur me par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)

Andaj gjyqtari i vetëm gjykues, në kuptim të nenit 2, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 69, 70 dhe 181 par. 4 lidhur me par. 2 të KPRK-së, si dhe neneve 364, 452, 460 të KPPRK-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

Me dënim burgu në kohëzgjatje prej 1 /një / viti, i cili dënim nuk ka për tu ekzekutuar nëse i pandehuri në afat prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykim nuk kryen vepër tjetër penale (koha e verifikimit), në të kundërtën dënimi i tillë do të revokohet.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 Euro (tridhjetë euro), si dhe konform nenit 36 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 /njëzet/ Euro, që të dy shumat brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

I dëmtuari M.A.R. nga fsh.... K.Ferizaj, rruga “....” nr....., ka hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm me aktakuzën e saj PP./II.nr.220/21, të datës 11.03.2021, ka ngarkuar të akuzuarin, për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 par.4 lidhur me par.2 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe t'i shqiptohet sanksioni penal i paraparë me ligj.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet te realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar për të akuzuarin gjykohet nga gjyqtari i vetëm gjykues dhe vendi ku është kryer ose tentohet të kryhet vepra penale.

Gjykata duke vepruar sipas akuzës, me datë 16.08.2024, ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor, në të cilën seance kane prezantuar prokurori i shtetit, i dëmtuari, dëshmitarët, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij i caktuar sipas detyrës zyrtare.

Në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ka udhëzuar të akuzuarin për të drejtat e tija në kuptim të nenin 319 par.1 dhe 2 të KPPRK-së dhe pasi që i akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata ka deklaruar se heqë dorë nga leximi i aktakuzës pasi që një kopje të saj e kam pranuar në shqyrtimin fillestar dhe njëjta në këtë rast edhe më është lexuar nga prokurori e shtetit dhe për këtë nuk kam nevojë të me lexohet pasi që atë e kam të krejtësisht të qartë, gjyqtari pasi që është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, konform nenit 321 paragrafi 1 të KPPRK-së, i ka afruar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pa fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar.

I akuzuari në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se e pranoj fajësinë për veprën penale me të cilën më ngarkon aktakuza e prokurorit të shteti për të gjitha pikat e saj.

Pasi që i akuzuari deklaroi se e pranon fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, gjyqtari në kuptim të nenit 322 par 2 të KPPRK-së, morri mendimin e prokurorit të shtetit dhe të dëmtuarit.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari ka deklaruar se pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprën penale Kanosja nga neni 181 par. 4 lidhur me par. 2 të KPRK-së, pasi që një pranim i tillë është bërë në mënyrë vullnetare

duke kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ky pranim është në përputhje të plot me dispozitat e nenit 242 të KPPRK-se dhe i mbështetur në provat dhe fakteve që i përmban aktakuza, andaj i propozoj gjykatës që të njëjtin ta pranoj.

Avokati mbrojtës i të akuzuarit lidhur me pranimin e fajësisë së të akuzuarit deklaroi, se pasi që i pandehuri është konsultuar mjaftueshëm me mbrojtësin lidhur me veprën penale si dhe për pasojat dhe përfitimet që ka i njëjti me rastin e pranimit të fajësisë. I pandehuri vullnetarisht e pranon fajësinë për këtë veprë penale dhe i propozoj gjykatës që të bëj pranimin e fajësisë nga i njëjti.

I dëmtuari lidhur me pranimin e fajësisë së të akuzuarit deklaroi se e mbështes fjalën e prokurorit të shtetit, nuk e kundërshtojmë pranimin e fajësisë së të akuzuarit.

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 242 par. 2 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajit është bërë vullnetarisht nga i akuzuari dhe atë pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, pranimi i fajit nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve, se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, pranimi i fajit mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit siç janë, procesverbali mbi bastisjen e banesës dhe personave, i datës 27.11.2020, vërtetim mbi bastisjen e shtëpisë, leje për armë gjahu me numër serik të kartelës CF, në emër H.H. si dhe të gjitha shkresat tjera që gjenden në lëndë.

Meqenëse i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues konform nenit 242 paragrafit 6 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin gjyqësor pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Pasi që Gjykata ka konstatuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është në përputhje me kërkesat nga neni 242 par. 2 KPPRK-së, konform nenit 322 paragrafi 4 të KPPRK-së, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Fjala përfundimtare e palëve

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, mbetem në tërësi pranë aktakuzës dhe kualifikimit juridik kundër të akuzuarit për veprën penale kanosje të paraparë në nenin 181 par. 4 lidhur me par. 2 të KPRK-së. Gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor pasi që i pandehuri e pranoi fajësinë për të cilën akuzohet i cili pranim është në përputhje me dispozitat ligjore dhe provat që përmban aktakuza, andaj i propozoj gjykatës që gjatë matjes së dënimit dhe shqiptimit të sanksionit penal të ketë për bazë rrethanat rënduese dhe lehtësuese të paraparë në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, si rrethanë rënduese të merret shkalla e lartë e dashje e paraparë në nenin 70 par. 2 pika 2.2, ndërsa si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajit nga ana e të pandehurit e paraparë në neni 70 par. 3 pika 3.10, andaj i propozoj gjykatës që të njëjtin ta shpallë fajtor dhe ti shqiptoj një sanksion penal të paraparë me ligj.

I dëmtuari në fjalën përfundimtare deklaroi se, e mbështes në tërësi fjalën e prokurorit të shtetit, nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale e as që kam ndonjë kërkesë pasurore juridike pasi që me të akuzuarin për mosmarrëveshjen që kemi pasur tani jemi marr vesh dhe nuk kemi probleme në mes vete.

Mbrojtësi i të akuzuarit në fjalën përfundimtare deklaroi se, meqenëse i akuzuari në shqyrtimin e sotëm gjyqësor e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza i propozojmë gjykatës që me rastin e caktimit dhe matjes së dënimit të merr parasysh veçanërisht si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë. Konsiderojmë se në këtë çështje penale sa i përket rrethanave në të cilat është kryer vepra penale konkrete nuk ka elemente apo rrethana rënduese për të pandehurin pasi që vepra penale nga i njëjti është kryer rastësisht dhe pa dashje. Po ashtu si rrethanë lehtësuese të merret fakti se i dëmtuari në shqyrtimin e sotëm nuk iu ka bashkëngjitur ndjekjes penale dhe nuk ka kërkuar kërkesë pasurore juridike pasi që është pajtuar me të pandehurin. Po ashtu si rrethanë lehtësuese të merret se i njëjti asnjëherë më parë nuk ka qenë i gjykuar, është i moshë së re dhe është njeri familjar. Nga këto rrethana të përmendura i propozojmë gjyqtarit të çështjes që ndaj të akuzuarit të caktoj dënim të

kushtëzuar pasi që edhe me të njëjtin do të arrihet qëllimi i sanksionit penal që parashihet me ligj.

I akuzuari në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, e përkrahi në tërësi atë që tha mbrojtësi im –avokati tani në fjalën e tij përfundimtare dhe dua të shtoj se më vjen keq që ka ndodh rasti i cili ka qenë i rastësishëm dhe besoj se në të ardhmen këso lloj veprime nuk do të përsëris dhe tani i kërkoj falje publike të dëmtuarit.

Duke vlerësuar në aspektin juridik, gjykata gjeti se në veprimin e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Kanosja nga neni 181 par.4 lidhur me par.2 të KPRK-së, ashtu siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në të cilin është përshkruar data, vendi, koha dhe mënyra apo rrethanat e kryerjes së veprës penale për çka dhe i akuzuari u shpallë fajtor dhe ju shqiptua dënim siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes dhe caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se i akuzuari e ka bërë pranimin e fajësisë, pendimin e tij dhe kërkim faljen ndaj të dëmtuarit, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të përsërit vepra të tilla apo të ngjashme, se për herë të parë ka ra ndesh me ligjin, se i dëmtuari nuk i është bashkangjitur ndjekjes penale, ndërsa rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se i akuzuari ka bërë pranimin e fajësisë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethana të kryerjes, rrezikshmërisë së saj dhe autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi ti përmbaj personat tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Vendimi mbi kërkesën pasurore-juridike, është marruar në kuptim të nenit 460 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle, është marr në kuptim të dispozitës së nenit 452 par.
1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 36 par 3
pika 3.1, Nr. 08/L-109 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të theksuarave më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ,
DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL
2021:047326, datë 20.08.2024**

Zyrtare ligjore
Kimete Bytyqi

Gjyqtari i vetëm gjykues:
Imri Sejda

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në
Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit
të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.